



Shëndeti psiqik

Në Zvicër nuk bëhet dallim në mes sëmundjeve psiqike dhe fizike. Sigurimi bazë e paguan trajtimin e sëmundjeve psiqike te njerëzit e specializuar si dhe qëndrimin në klinikë.

Mbështetja dhe këshillimi

Për situata të vështira personale apo familjare, ka në Zvicër shumë persona të specializuar të cilët ndihmojnë. Sigurimi bazë (Grundversicherung | assurance de base) e paguan trajtimin te sëmundjet psiqike te njerëzit e specializuar të çertifikuar me ligj si psikiatret dhe psikiatrit. Qëndrimet në klinikë po ashtu paguhen. Kush ka probleme, mundet falas me ju drejtue këshillimoreve anonime. Kështu këshillon Dora e Zgjatur (Dargebotene Hand | la Main tendue) përmes telefonit, E- Mailt apo chat (telefon 143, www.143.ch). Mirëpo edhe mjekja apo mjeku familjar munden të ndihmojnë. Kur një person është akut i rrezikuar, që vetes apo tjetrit mund t`i bëjë diçka, duhet të veprohet shpejt. Në këto raste urgjente ndihmon policia (telefoni 117).

Fëmijët dhe të rinjët

Për të rinjët me probleme psiqike është si hap i parë i mirë dhe falas, shërbimi psikologjik për të rinjë (Jugendpsychologischer Dienst | Service de psychiatrie pour les jeune). Edhe prindërit, të cilët brengosen për fëmijët e tyre, munden me u lajmëruë aty. Mbështetje anonime falas për fëmijë dhe të rinjë ofrojnë thirrja emergjente për fëmijë (Kindernotruf | Urgences enfants) përmes telefonit, E-Mal apo Chat (Tel.147, www.147.ch). Për raste emergjente psikiatrike te fëmijët dhe të rinjët ka këto adresa:

- qendra emergjente NZKJP: Rajonet qyteti i Bernit dhe qendra; Oberaargau (pjesa verilindore e Bernit) dhe Emmental; Oberland (telefoni 031 932 88 44, çdo ditë, 24 orë.
- Ambulanca KJP (psikiatria për fëmijë dhe të rinjë), rajoni Biel (telefoni 032 328 66 99, e hënë deri e premte prej ora 8 deri 18)
- Qendra spitalore Biel (Telefoni 032 324 24 24, çdo ditë, prej ora 8 deri 18).



Sëmundjet e vesit

Te sëmundjet e vesit ndihmojnë qendrat të këshillimit për vese (Suchtberatung | Suchtberatung | Centre de consultation en matière d'addiction). Këto vende ofrojnë këshillim dhe trajtim në besim, falas. Edhe kur njeriu brengoset për për të afërmit dhe personave që ka pranë, mundet t`i kontaktoj këto qendra këshilluese. Te sëmundjet e vesit nuk numrojnë vetëm vesi i alkoolit-apo drogës. Edhe te veset e tjera si vesi i lojës, i blerjes apo internetit edhe te çrregullimi në të ngrënë, ndihmojnë këshillimoret e vesit tutje. Pyetjet mund të bëhen edhe përmes e-mailit.

Traumatizimi

Kush në jetë përjeton gjëra të këqija dhe nuk mundet t`i harroj, duhet të marr mbështetje. Sepse traumatizimet janë sëmundje që duhet marr seriozisht. Përgjatë këshillimit dhe ofertave mbështetëse për probleme psikike dhe sëmundje, ka edhe vende me njerzë të specializuar për trajtime të viktimave të luftës dhe torturës.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/shendeti/shendeti-psiqik